

VENDIM
Nr. 280, datë 6.11.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 171, DATË 31.7.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘EZ-5 ENERGY’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 30 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2778 prot., datë 4.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 mw””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k.

- Me vendimin e ERE nr. 171, datë 31.7.2025, shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 mw, për një afat 30-vjeçar.

- Në kuptim të sa përcaktuar në pikën 2 të vendimit, shoqëria, përpara fillimit të operimit, duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaik me rrjetin e transmetimit.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/9 prot., datë 22.10.2025, ka depozituar kopjen e njehsuar me origjinalin të marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik “EZ-5 Solar 2”, nënshkruar mes shoqërisë “OST” sh.a. dhe “EZ-5 Energy” sh.p.k., me nr. 677/10 prot., datë 20.10.2025 dhe ka kërkuar rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, në kuadër të plotësimit të kushteve të përcaktuara në vendim.

- Nga raportimi periodik i “OST” sh.a. për muajin shtator 2025, rezulton se ky central nuk ka filluar ende prodhimin e energjisë elektrike.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, dhe me depozitimin nga shoqëria të marrëveshjes së nënshkruar me “OST” sh.a., rezulton se ky kusht është i përmbushur.

- Për pasojë, pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, vlerësohet të shfuqizohet.

- Gjithashtu, pika 5 e këtij vendimi, e cila përcakton se vendimi është objekt rishikimi në rast të plotësimit ose mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4, vlerësohet të ndryshohet për të reflektuar faktin që pika 2 është tashmë e përmbushur.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, duhet

të shfuqizohet, pasi shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

- Gjithashtu, pika 5, e vendimit nr. 171/2025 përcakton se: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

- Në kuadër të plotësimit të pikës 2 vlerësohet të bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 171, datë 31.7.2025, ndryshohet si vijon:

“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti